



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1938/2 prot.,

Datë 09.08.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Amber Dental*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. REF-75128-07-13-2023, me objekt: “*Materiale mjekimi stomatologjike*”, me fond limit të lotit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “TRIMED” SHPK  
Adresa: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Km 10, Zona Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër  
Adresa: Rruga “Bujar Bishanaku”, Shkodër.

**Persona të Interesuar:** Operatori ekonomik “*Amber Dental*” SHPK  
Adresa: Njësia Administrative Nr.7, Rruga “*Studenti*” Pallati 14/E, Tiranë.

Në datën 08.08.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1938/2023 protokoll, e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra*”, me Nr. REF-75128-07-13-2023, me objekt: “*Materiale mjekimi stomatologjike*”, me fond limit të lotit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 31.07.2023 nga autoriteti kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Amber Dental*” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “TRIMED” SHPK, në ankesën me nr. 1938 prot., datë 08.08.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Amber Dental” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Amber Dental” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

### **“Shtojca 8**

**[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]**

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Amber Dental” SHPK, pasi nuk disponon Licensë II.7.B.1 – Për Tregtim të Barnave”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.08.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**